Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 20/148
Datë: 29.06.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor 2023, merr këtë:

# V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti në Fushën e Patentë Shoferit.

2. Obligohet Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***
*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo životne sredine, prostornog planiranja i infrastrukture*
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

# KONCEP DOKUMENT NË FUSHËN E PATENTË SHOFERIT

Përgatitur nga: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nëntor, 2022

## Përmbajtja

Përmbledhje e koncept dokumentit ..... 3
Hyrje ..... 4
Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit ..... 5
Kapitulli 2: Objektivat ..... 19
Kapitulli 3: Opsionet ..... 20
Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim **Error! Bookmark not defined.**
Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit ..... **Error! Bookmark not defined.**
Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë [përcaktohet veç e veç për secilin koncept dokument] ..... **Error! Bookmark not defined.**
Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme ..... 33
Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave ..... 34
Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi ..... 34
Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve ..... 35
Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme ..... 36
Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet ..... 39
Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm ..... 40
Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin ..... 40
Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik ..... 40
Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqëror ..... 45
Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore ..... 49
Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore ..... 52

# Përmbledhje e koncept dokumentit

Procesi i marrjes së patentë shoferit është i një rëndësie të madhe në rritjen e sigurisë në trafikun rrugor. Në këtë proces kompleks janë përfshirë institucione të ndryshme në nivel qendror, subjekte që merren me trajnimin e kandidatëve për shoferë si dhe personeli profesional në këtë fushë. Ky koncept dokument trajton çështjen e marrjes së patentë shoferit në Republikën e Kosovës, e cila rregullohet me Ligjin nr. 05/L-064 për patentë shofer (i miratuar në Kuvendin e Kosovës në maj 2016, i shpallur me dekretin Nr. DL-011-2016, datë 03.06.2016 nga Presidenti i Republikës i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës nr.17 të datës 10 qershor 2016 i cili ka hyrë në fuqi më datë 25.06.2016).

Ligji për patentë shoferë përcakton kushtet dhe kriteret për marrjen e patentë shoferit për të gjitha kategoritë, licencimin e subjekteve që trajnojnë kandidatët, licencimin e stafit profesional (ligjëruesit profesionistë, instruktorë shoferë), organizimin e dhënies së provimit për patentë shofer, kushtet për fitimin e të drejtës së drejtimit të mjetit, kushtet shëndetësore, procedurat për aplikimin, marrjen, rinovimin dhe zëvendësimin e patentë shoferit, si dhe çështje të tjera që lidhen me të.

Informacionet e përgjithshëm janë paraqitur në tabelën vijuese:

| **Informacionet e përgjithshme** | |
|---|---|
| Titulli | Koncept dokument për Patenë Shoferë |
| Ministria bartëse | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës<br>Departamenti i Automjeteve |
| Personi kontaktues | Habib Hasani, kryesues i ekipit punues - MMPHI<br>Nr. Tel. 02830508 |
| PSO | 3.4.2.<br>3.4.2.1. Caktimi i personit përgjegjës dhe formimi i grupi punues<br>3.4.2.2. Hartimi i projekt udhëzimit<br>3.4.2.3 Diskutimi paraprak dhe implementimi i vërejtjeve dhe sugjerimeve<br>3.4.2.4 Diskutimi paraprak dhe implementimi i vërejtjeve dhe sugjerimeve<br>3.4.2.5 Përcjellja në departamentin ligjor.<br>3.2.4.6. Shqyrtimi dhe përcjellja në Qeveri për miratim |
| Prioriteti strategjik | Përmirësimi i performancës institucionale dhe sektoriale me fokus në sigurinë rrugore, hekurudhore dhe ajrore |

| **Vendimi** | |
|---|---|
| Çështja kryesore | Rregullimi jo i duhur i procesit të marrjes së patentë shoferit |
| Përmbledhje e | Plotësohet pas konsulltimeve |

| | |
|---|---|
| konsultimeve | |
| Opsioni i propozuar | **Opsioni 3.** |

| **Ndikimet kryesore të pritshme** | |
|---|---|
| Ndikimet buxhetore | Ligji i ri për patentë shoferë, nuk do të krijojë kosto shtesë buxhetore në zbatimin e tij. |
| Ndikimet ekonomike | Hartimi i ligjit të ri për Patentë Shoferi pritet të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik si më poshtë:<br>▪ Ndikimet në subjekte që merren me aftësimin e kandidatëve për shoferë dhe në zhvillim ekonomik në përgjithësi<br>▪ Ndikimet në kuadrin profesional në fushën e patentë shoferit |
| Ndikimet shoqërore | -Ndikimi në ngritjen e kuadrit profesionit në fushën e patentë shoferit<br>-Ndikimi në mirëqenien e aktereve të përfshirë në procesin e marrjes së patentë shoferit |
| Ndikimet mjedisore | Do të reduktohen shpenzimet e ndryshme në procesin e marrjes së patentë shoferit që ndikojnë në mbrojtjen e ambientit. |
| Ndikimet ndër-sektoriale | Ndikime në të drejtat themelore dhe jo të drejtpërdrejta në kategori tjerat të akterëve në procesin e marrjes së patentë shoferit. |
| Ngarkesat administrative për kompanitë | Ka ndikime të ngarkesave administrative të Institucioneve qendrore, licencimi dhe përtëritja e licencës për subjektet dhe kuadrit profesional që janë të përfshirë në procesin e marrjes së patentë shoferit. |
| Testi i NVM-ve | Testi i NVM-ve nuk është zbatuar, sepse kemi të bëjmë me procesin e marrjes së patentë shoferit, që shumica janë mikro ndërmarrje. |

| **Hapat e ardhshëm** | |
|---|---|
| Afatshkurtër | Hartimi i Ligjit për Patenë Shoferë |
| Afatmesëm | Fuqizimi i kapaciteteve në kuadër të MMPHI |

## HYRJE

Ky koncept dokument, ka për qëllim që nëpërmjet prezantimit të detajuar i cili bazohet në analizimin dhe vlerësimin e Ligjit për patentë shoferi, duke indentifikuar problemet me të cilat po ballafaqohet procesi i testimit të kandidatëve për patentë shofer, duke filluar nga subjektet të cilat janë të autorizuar për aftësimin e kandidatëve për patentë shoferë, për barrierat administrative dhe Institucioni i cili është kompetent për vlerësimin e testimeve për patentë shoferë të cilat në bazë të Ligjit Nr. 05/L-064, për Patentë shoferi dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë të këtij ligjit janë përgjegjëse për procesin e marrjes së patentë shoferit.

Informacionet e përgjithshme për koncept dokumentin janë paraqitur në tabelën 1.

*Figura 1: Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin*

| | |
|---|---|
| Titulli | Koncept dokument në fushën e patentë shoferit |
| Ministria bartëse | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Departamenti i Automjeteve |
| Personi kontaktues | Habib Hasani, kryesues i ekipit - MMPHI Nr. Tel.:028530807 |
| PSO | 3.4.2. |
| Prioriteti strategjik | Përmirësimi i performancës institucionale dhe sektoriale me fokus në sigurinë rrugore, hekurudhore dhe ajrore |
| Grupi punues | Grupi punues: 1. Habib Hasani, kryesues, MMPHI, 2. Imer Thaqi, anëtarë, MMPHI, 3. Vlora Hasanramaj, anëtare, MMPHI, 4. Emine Krasniqi, anëtare, MMPHI, 5. Jakup Hoti, anëtarë, MMPHI, 6. Shqipe Hyseni, anëtare, MMPHI dhe, 7. Vjollca Kelmendi,anëtare, MMPHI. |
| Informata shtesë | Nuk ka |

# Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

Procesi i marrjes së patentë shoferit ka një rëndësi të madhe dhe është njëri ndër faktorët kryesore të sigurisë rrugore. Ekzistojnë modele të ndryshme të marrjes së patentë shoferit si në vendet e rajonit ashtu edhe brenda shteteve të BE-ës si edhe tek shtetet më të zhvilluar perëndimore. Procesi i marrjes së patentë shoferit në vendin tonë rregullohet me Ligjin për patentë shoferë 'i cili përcaktojnë kushtet dhe kriteret për marrje të patentë shoferit për kategoritë përkatëse, që bazohet me Direktivën 2006/126/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 20 dhjetor 2006 për Patentë Shofer dhe me ndryshimin dhe plotësimin e kësaj Direktivës, licencimi i auto shkollave, licencimi i kuadrit profesional ligjëruesin profesionalë, instruktorë të shoferëve, pyetëseve (ekzaminerët), procedurat për aftësim të kandidatëve për shoferë, për dhënie të provimit për patentë shoferi, për programin e trajnimit për trajnerë nga fusha e patentë shoferit, për trajnimet periodike për shoferë profesionistë të cilët i drejtojnë automjetet e transportit për mallra dhe udhëtarë, për kushtet për të fituar të drejtën për drejtim të automjetit, për kategoritë e automjeteve, për kushtet shëndetësore, për procedurat për aplikim, për marrje, për vazhdim dhe ndërrim të patentës së shoferit, si dhe për çështje të tjera lidhur me to.

Problemi kryesor në fushën e patentë shoferit janë ngarkesat e panevojshme administrative të Institucioneve dhe subjekteve në procesin e marrjes së patentë shoferit, mos lejimi i kuadrit profesional të vazhdojnë aktivitet në fushën e patentë shoferit, pengesat në konvertimin e

patentë shoferit tonë në patentë shoferë të ndonjë shtetit tjetër, dispozitat ligjore kontradiktore dhe të pa harmonizuar, dispozitat e paqarta, dispozitat e vjetruar dhe të pa zbatueshme në praktik, si dhe mos implementimi i standardeve dhe praktikave të vendeve me te zhvilluar BE-ës.

Koncept Dokumentit në fushën e Patentë Shoferit, e që ka për qëllim të shqyrtoj dhe ti analizoj problemet të cilat janë hasur gjatë zbatimit praktik e për bazë janë marrë:

- Raporti ex-pos Ligjit Nr.05.L-064 për Patentë Shoferi,
- Informatat nga Institucionet qendrore që janë të përfshira në vlerësimin e kandidatëve në procesin e marrjes së patentë shoferit;
- Informatat nga Institucionet qendrore që merren me lëshimin, vazhdim dhe ndërrim të patentës së shoferit;
- Informatat e subjekteve të autorizuar të përfshira në fushën e patentë shoferit;
- Ankesat e vazhdueshme të shoqatave të subjekteve të cilat merren me aftësimin e kandidatëve;
- Informata nga aplikuesit për marrjen e patentë shoferit,
- Informata nga profesionistet e fushës së patentë shoferit,
- Takimet me grupe te interesit, etj.

Në procesin e marrjes së patentë shoferë, i cili është i rregulluar me ligjin aktual për patentë shoferë për të cilin hartohet koncept dokumenti, janë të ndërlidhura edhe legjislacionet tjera primare të cilat janë të paraqitur në figurën nr.2.

*Figura 2: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore*

| Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor | Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare | Institucioni(-et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim | Roli dhe detyrat e Institucionit(-eve) |
|---|---|---|---|
| 1. LIGJI Nr. 05/L-64 për Patentë Shoferi , GZ e RK/ Nr. 17 / 10 QERSHOR 2016, PRISHTINË | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12516 | MMPHI, MPB, MSH | Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë të MMPHI, MPB |
| 2. LIGJI Nr. 06/L-066 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 05/L-064 PËR PATENTË SHOFERI, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 15 / 11 TETOR 2018, PRISHTINË | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12516 | MMPHI, MPB, MSH | Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë të MMPHI, MPB |
| 4. Ligji Nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor , | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12822 | MMPHI, MPB, MSH | Mbikëqyrja në kuadër të |

| | | | |
|---|---|---|---|
| GZ e RK nr.32/ 5 Shtator 2016 , Prishtinë | | | fushëveprimit të Ministrisë të MMPHI, MPB |
| 5. Ligji Nr. 05/L - 132 për Automjete, GZ e RK , / Nr. 15 / 11 maj 2017, PRISHTINË | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14671 | MD, MMPHI, MPB | Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë të MMPHI, MPB |
| 6. Ligji Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, GZ e RK / Nr. 33 / 8 shtator 2016, Prishtinë | https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12839 | MD, MMPHI, MPB | |
| 7. Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative , GZ e RK /Nr. 20 / 21 Qershor 2016, Prishtinë | https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12559 | MD, MMPHI, MPB | |
| Ligji Nr. 03/L- 212 i Punës | https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2735 | MPMS, MMPHI, MPB | |
| LIGJI NR. 06/L - 114 PËR ZYRTARËT PUBLIKË | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=25839 | MD, MMPHI, MPB | |
| LIGJI Nr. 06/L -011 PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT NË USHTRIMIN E FUNKSIONIT PUBLIK | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16314 | MD, MMPHI, MPB | |

Në fushën e patentë shoferit përveç legjislacionit primar që u cekë më lartë janë të përfshirë edhe legjislacionin sekondar nga fushat e ndryshme që janë të ndërlidhura me këtë fushë.

Brenda Ministrisë në fushën e patentë shoferit sipas RREGULLORES (QRK) NR. 16/2015 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS, janë të përfshirë këto departamente:

- Departamenti i Automjeteve – merret me licencimin e subjekteve dhe kuadrit profesionist në fushën e patentë shoferit si dhe organizmin e provimeve profesionale në këtë fushë,
- Departamenti i Patentë Shoferit i cili merret me organizimin e provimit për patentë shofer;
- Departamenti për Inspektorat- i cili në kuadër të saj ka Divizionin për Inspektorat të Auto shkollave, i cili bënë Mbikëqyrjen e punës së subjekteve që merren me aftësimin e kandidatëve për shoferë.

Për të kuptuar në mënyrë më specifike problemin aktual në fushën që trajtohet me këtë koncept dokument, është zhvilluar dhe elaboruar pema e problemit në vijim.
Duke u bazuar në Udhëzuesin dhe Doracakun për hartimin e koncept dokumenteve dhe në fig 3 është elaboruar pema e problemit.

*Figura 3: Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet*

| | |
|---|---|
| **Efektet** | a)Shërbimet jo cilësore dhe ngarkesat administrative burokratike në procesin e marrjes së patentë shoferit |
| | b)Zvarritje e punëve dhe aktiviteteve të Institucioneve, subjekteve dhe të kuadrit profesional në procesin e marrjes së patentë shoferit |
| | c)Largimi i kuadrit profesional nga procesi i marrjes së patentë shoferit |
| | d) Mos implementimi i Direktivave Evropiane si dhe të standardeve dhe praktikave të vendeve të zhvilluar të BE-ës në procesin e marrjes së patentë shoferit<br>e) Zvogëlimi i sigurisë rrugore dhe ndotja e ambientit |
| **Problemi kryesor** | Rregullimi jo i duhur procesit të marrjes së patentë shoferit |
| **Shkaqet** | a) Barrierat dhe rregullimi jo duhur ligjore në fushën e patentë shoferit<br>b) Dispozitat e pa qarta, pa harmonizuara, pa zbatueshme dhe kontradiktore në ligjin ekzistues.<br>c) Zbatimi i dispozitave në mënyrë retro aktive në fushën e patentë shoferit<br>d) Mungesa e kornizës ligjore për përfshirjen standardeve dhe praktikave të BE-ës në fushën e patentë shoferit me te mira te vendeve të BE dhe Direktivave Evropiane në fushën e patentë shoferit |

Pas përkufizimit të problemit të cekur me lartë në vijim në mënyrë kronologjike janë eloboruar shkaqet:

a) *Barrierat dhe rregullimi jo i duhur në fushën e patentë shoferit*

Kushtet bazë për licencim të auto shkollës janë të përcaktuar në nenin 5, ku përveç tjerash parashihet një udhëheqës administrativo- profesional (nën nënpargarfi1.1.1.), së paku dy (2) instruktorë të shoferëve për kategorinë B, kurse së paku një (1) instruktor të shoferëve për secilën kategori për të cilën licencohet (nën nënparagarfi 1.1.2.), të jetë e pajisur me hapësira pune...me poligon (nën nënparagrafi 1.6.3).

Subjektet të cilat janë të përfshira në trajnimin e kandidatëve ( neni 6 paragrafi 2), ku është përcaktuar se Licenca lëshohet vetëm për një (1) kategori e cila vlen pesë (5) vjet, me mundësi të përtëritjes.

Personi përgjegjës në auto shkollë për mbarëvajtjen e punës së auto shkollës është Udhëheqësi Profesional Administrativ (neni 9) i cili kryen punët e rëndomta administrative.

Për kuadrin profesional - ligjëruesin profesional licenca lëshohet me vlefshmëri për pesë (5) vite me mundësi te përtëritjes (neni 10 paragrafi2).

Institucionet që merren me vlerësimin e kandidatëve për instruktor parashihet se për mbajtjen
e provimit profesional për instruktor shofer "Së paku dy (2) zyrtarë nga cilido ekip i emëruar nga
Ministria t'i kenë të përfunduara studimet - së paku nivelin master nga lëmi i komunikacionit,
(nenin 16.3), ndërsa për pjesën praktike "Së paku një (1) zyrtar nga cilido ekip i emëruar nga Ministria
në bazë të këtij neni t'i ketë të përfunduara studimet -nivelin master nga lëmi i komunikacionit rrugor" (neni 17.3).

Për kuadrin profesional ku parashihet se "Instruktori i shoferëve i cili jep provimin profesional i lëshohet licenca e cila vlen pesë (5) vite me mundësi të përtëritjes së licencës" (neni 18.1) si dhe "për instruktor të shoferëve të kategorisë A me vlefshmëri për pesë (5) vite me mundësi të përtëritje të licencës" (neni 19.2).

Për institucionet që parashihet që "Zyrtarët, të cilët e mbajnë provimin profesional për vlerësim të
pyetësve të kandidatëve për shoferë nga pjesa teorike, e të cilët caktohen nga Ministria, duhet t'i kenë të përfunduara studimet-nivelin Bachelor nga lëmi i komunikacionit rrugor" ( neni 33 nën paragrafi 1.2).

Për institucionet parashihet që: Zyrtarët të cilët e mbajnë provimin profesional për pyetës të kandidatëve për shoferë nga pjesa praktike, caktohen nga Ministria ku "Së paku një (1) zyrtar nga
cilido ekip i emëruar nga Ministria duhet t'i ketë të përfunduara studimet - nivelin Bachelor nga lëmi i komunikacionit rrugor" (neni 34 paragrafi 3).

Për kuadrin profesional që "Licenca e pyetësit të drejtimit" i lëshohet personit i cili tregon rezultat
pozitiv në provim për licencim të pyetësit e cila vlen tri (3) vite, me mundësi përtëritjes të licencës" (neni 36 paragrafi 1).

Auto shkolla është e detyruar që përmes postës elektronike ta njoftojë Ministrin në momentin që kandidati regjistrohet për aftësim për drejtim të automjeti (neni 43 paragrafi 1).

Shoferi i cili ka patentë shoferin e kategorisë A2 ka të drejtë të drejtojë automjetin e kategorisë A1 (neni 85 paragrafi 7) përkatësisht shoferi i cili ka patentë shoferin e kategorisë A, që ka të drejtë t'i drejtojë automjetet e kategorisë A1 dhe A2 ( neni 85 paragrafi 8) e jo mjetet e kategorisë AM .

Shoferi mund të aplikojë për vazhdim të patentës së shoferit vetëm gjashtë (6) muaj para skadimi të
vlefshmërisë së patentës së shoferit (neni 94 paragrafi 1).

b) *Dispozitat e pa qarta, pa harmonizuara, pa zbatueshme dhe kontradiktore në ligjin ekzistues*

Në ligjin aktual për patentë shoferë, ka mos harmonizim të dispozitave brenda nenit 5 përkatësisht të paragrafëve 3 dhe 4 të këtij nenit që ka të bëjë me automjete dhe rimorkio që krijon konfuzitet, dhe pa mundësi në zbatim.

Për ligjëruesin profesional në auto shkollë i cili punon me honorar, nuk specifikohet në mënyrë të detajuar se në sa auto shkolla mund të angazhohet, apo për bazë të merret vetëm fondi i orëve i lejuar (neni 5; 1.3).

Për mënyrën e angazhimit të pyetësve të drejtimit, në ligjin aktual në nenin 29 është përcaktuar se " Vlerësimin e kandidatëve për shoferë nga pjesa praktike e kryen personi i licencuar për pyetës, i autorizuar me vendim të ministrit, ndërsa me hyrjen e ligjit në fuqi për " Zyrtarët Publike" nuk lejohet kjo mënyra e angazhimit.

Shoferi i cili ka licencën për instruktor mund të licencohet për kategorinë A nëse i plotëson kushtet në vijim (neni 19), ka paqartësi se a duhet me pas trajnimin bazë apo jo.

Zyrtari, i emëruar nga Ministria, i cili e mban provimin teorik për patentë shoferi, duhet t'i plotësojë kushtet në vijim ai ose ndonjë anëtar i familjes së ngushtë të tij në tre (3) vjetët e fundit të mos ketë qenë i angazhuar në çfarë do mënyre në auto shkollë (neni 27. 1.6.)

Te neni 30 i ligjit në fjalë ka paqartësi sa i për ketë nën paragrafit 1.2. ku cekët " ka së paku të përfunduara studimet - nivelin Bachelor nga lëmi i komunikacionit" kandidat për pyetës të cilët kanë përfunduar masterin në lëmin e komunikacionit deri sa Bechelorin e kanë nga fushat tjera.

Gjithashtu te i njëjti neni 30 i ligjit në fjalë nën paragrafin 1.7. cekët në "tri (3) vitet e fundit ai ose ndonjë anëtar i familjes së ngushtë të tij të mos ketë qenë i angazhuar në çfarë do funksioni në auto shkollë" ka pa qartësi në interpretim sepse nuk specifikohet qartë çka konsiderohet anëtarë i ngushtë i familjes.

Për pyetës të drejtimit mund të licencohet personi i cili i plotëson kushtet në vijim: "i ka së paku të përfunduara studimet - nivelin Bachelor nga lëmi i komunikacionit" (neni 30 nën paragrafi 1.2.) si dhe në tri (3) vitet e fundit ai ose ndonjë anëtar i familjes së ngushtë të tij të mos ketë qenë i angazhuar në çfarë do funksioni në auto shkollë (neni 30 nën nën paragrafi 1.7).

Pyetësi për tu licencuar për kategoritë shtesë duhet të ketë:" licencën e kategorisë B së paku tri (3) vite ose ka patentë shoferin mbi pesë (5) vite për kategorinë përkatëse" (neni 31 nën nënparagrafi 1.1.) ka paqartësi a duhet të plotësohen një apo dy kriteret për licencim.

Te dispozitat e nenit 63, 2.7 dhe 2.8 ka mos harmonizim të dispozitave sa i për ketë masës më të madhe te lejuar të bashkësisë së mjeteve të kategorisë CE.

Detyrat dhe përgjegjësit e inspektorit të Auto shkollave (neni 126) nuk janë të harmonizuar me Ligjin për Inspektorat.

Dispozita është e pazbatueshme ku parashihet se Ministria nxjerr akt nënligjor me të cilin e përcakton përmbajtjen dhe formën e testeve (neni 60 paragrafi 2) dhe se testet e provimit u dorëzohen anëtarëve të Komisionit në momentin e fillimit të provimit nga njëri prej personave të cilët e kanë përpiluar testin (neni 128 paragrafi 5), tani testimi është në mënyrë elektronike.

c) *Zbatimi i dispozitave retro aktive në fushën e patentë shoferit*

Ligjëruesi profesional bazuar në nenin 10 nën paragrafin 1.2. duhet t'i ketë të përfunduara studimet vetëm nga lëmi i komunikacionit, të barasvlershme me së paku 120 ECTS, sipas sistemit të Bolonjës.

Te neni 30, nën paragrafit 1.2. cekët se pyetësi i drejtimit duhet të ketë " ka së paku të përfunduara studimet - nivelin Bachelor nga lëmi i komunikacionit".

Personi i cili ka marrë pjesë në vlerësimin e kandidatëve për shoferë (në cilësinë e pyetësit), nuk i lejohet të themelojë apo të punojë në çfarëdo funksioni në auto shkollë një (1) vit nga data e fundit e mbajtjes së provimit (neni 124).

d)*Mungesa e kornizës ligjore për përfshirjen e standardeve dhe praktikave më të mira të vendeve më të zhvilluar të BE-ës në fushën e patentë shoferit*

Mungon korniza ligjore për standarde dhe praktikave me të mira të vendeve me të zhvilluar të BE-ës si dhe Direktivat Evropiane në fushën e Patentë Shoferit.

Në nenin 28 paragrafi 2 parashihet dispozita se caktimi i pyetësve bëhet sipas listës së plotë të pyetësve të licencuar, me radhë.

Vlerësimi i shkathtësive dhe i sjelljes për kategoritë B1, B dhe BE; ku përfshin së paku dy veprime (neni 63 paragrafi 4), të cilat kryhen në poligon (neni 63 paragrafi 6).

Mungojnë dispozitat për kompetencat e personit te autorizuar për caktimin e automjetit të adaptuar për personat me aftësi të kufizuar nga aspekti mekanik.

Në vijim në mënyrë kronologjike janë eloboruar efektet.

a) ***Shërbimet jo cilësore dhe ngarkesat e panevojshme administrative burokratike në procesin e marrjes së patentë***

Me ligjin aktual të patentë shoferit janë krijuar ngarkesa të panevojshme administrative burokratike
në procesin e marrjes se patentë shoferit të cilat janë të elaboruar në vijim.

Kushtet për subjektet që merren me aftësimin e kandidatëve për shoferë për të pajisur me licencë janë të stër ngarkuar e që ka të bëjë me numrin e madh të personelit, me hapësirat punuese dhe mjetet (neni 5);

Ekziston ngarkesë e panevojshme nëse subjekti për çdo kategori shtesë angazhon/nga një (1) instruktor shoferi (neni 5, 1.1.3), është financiarisht e pa qëndrueshme, pasi që disa kategori nuk kanë mbulesë për shkak numrit të vogël të kandidatëve posaçërisht te kategoritë e bashkësive të mjeteve.
Të gjitha kanë krijuar vështirësi në punën e subjekteve që merren me aftësimin e kandidatëve për shoferë, duke krijuar kosto të panevojshme.

Procedurat administrative të panevojshme burokratike të Institucionit që merren me rastin e licencimit dhe përtëritjes së licencës së subjektit që bënë aftësimi e kandidatëve për patentë shoferë (neni 6 .2, expos i ligjit për patentë shoferë). Për përtëritjen e licencës subjekti duhet të parashtroj kërkesë në Ministri duke dorëzuar tërë dokumentacionin i cili është i objekt i inspektimit në kontinutet i inspektoratit të Auto shkollave. Pas dorëzimit të kërkesës në Ministri, komisioni prej tre anëtarëve del në vendngjarje për ta konstatuar se subjekti në fjalë a i ka plotësuar kushtet për përtërije të licencës, duke krijuar kosto të panevojshme humbje kohe

për Institucionin dhe subjektin pasi që inspektorati e inspekton mbarëvajtjen e punë së auto shkollës.

Ngarkesë e panevojshme angazhimi i udhëheqësit profesional administrativ (neni 9) në auto shkollë, pasi që kemi të bëjmë me procedura administrative të rëndomta e jo me punët profesionale. Punët profesional i kryen ligjëruesi profesional në auto shkollë dhe instruktor shoferi të cilët licencohen nga Ministria dhe janë përgjegjës për mbarëvajtjen e aftësimit teorik përkatësisht praktik. Prandaj Udhëheqësi profesional në auto shkollë nuk ka kurrfarë ndikimi në ngritjen e cilësisë së aftësimit të kandidatëve për shoferë.

Ngarkesat e panevojshme për ripërtërije të licencës të ligjëruesit profesional në auto shkollë ( neni 10. 2, expos ligji për patentë shoferë). Ripërtërija e licencës së ligjëruesit profesional parashihet çdo pesë (5) vite. Ligjëruesi profesional në auto shkollë duhet të aplikoj në Ministri dhe ti nënshtrohet profesional pavarësisht që në kontinutet ka progres në fushëveprimin e tij, duke krijuar kosto dhe humbje kohe të panevojshme për kuadrin profesional dhe për institucionin i cili merret me testimet profesionale në fushën e patentë shoferit. I cili duhet të emëroj zyrtar në ekipe punuese duke humbur kohë dhe kosto të panevojshme dhe zyrtaret e e emëruar duhet ti lajnë punët ditore sipas përshkrimet të vendit të punës të merren me aktivitete shtesë.

Me ligjin aktual ka krijuar ngarkesa/barriera burokratike për institucionin që merret me organizimin e provimeve profesionale në fushën e patentë shoferit, për zyrtarët të cilët caktohen të mbajnë provimin profesional në fushën e patentë shoferit të cilat janë cekur në vijim:

- Për mbajtjen e provimit nga pjesa teorike të provimit profesional për instruktor shofer,parashihet " Së paku dy (2) zyrtarë nga cilido ekip i emëruar nga Ministria në bazë të këtij neni t'i kenë të përfunduara studimet - së paku nivelin master nga lëmi i komunikacionit (neni 16.3). Duke pasur parasysh qe kemi të bëjmë me mbikëqyrje administrative të provimit profesional , kjo dispozitë veç krijon barrierat në punët e institucionit që merret me mbajtjen e provimit profesional të lartë cekur.

- Për mbajtjen e provimit nga pjesa praktike të provimit profesional për instruktor shofer, parashihet " Së paku një (1) zyrtar nga cilido ekip i emëruar nga Ministria në bazë të këtij neni t'i ketë të përfunduara studimet - nivelin master nga lëmi i komunikacionit rrugor (neni 17.3)".Kemi rastin e përshkruar më lartë vetëm këtu kemi një anëtarë me pakë, a përkundër se tani kemi të bëjmë me vlerësimin e ngasjes që nën kupton punë profesionale.

- Për mbajtjen e provimit nga pjesa teorike të provimit profesional për pyetësin e drejtimit, parashihet se zyrtarët "t'i kenë të përfunduara studimet - nivelin Bachelor nga lëmi i komunikacionit rrugor (Neni 33. 1.2.). Kemi rastin e njëjtë sikurse te provimi profesional për licencimin e Instruktor shoferit, me mbikëqyrje administrative të provimit profesionale, duke krijuar barriera dhe ngarkesa administrative të panevojshme, në mbarë vajtjen e provimit profesional.

- Për mbajtjen e provimit nga pjesa praktike të provimit profesional për pyetësin e drejtimit, parashihet " Së paku një (1) zyrtar nga cilido ekip i emëruar nga Ministria në bazë të këtij neni

t'i ketë të përfunduara studimet - nivelin Bachelor nga lëmi i komunikacionit rrugor (neni 34.3)'. Kjo dispozitë ka krijuar ngarkesa dhe barriera Për pjesën praktike ku kemi të bëjmë me vlerësimin e ngasjes së kandidatit është kërkuar vetëm një (1) zyrtar t'i ketë të përfunduara studimet - nivelin Bachelor nga lëmi i komunikacionit. Është e pa qëndrueshme që për mbarëvajtjen e profesional nga pjesa teorike të kërkohen dy profesionist të fushës së komunikacionit, ndërsa kur kemi të bëjmë me vlerësim profesional praktik kërkohet vetëm një profesionist i fushës së komunikacionit.

Procedurat e panevojshme për ripërtërije të licencës së instruktor shoferit A dhe B ( neni 18 dhe 19, expos i ligjit për patentë shoferë). Instruktor shoferi i kategorisë A dhe B duhet të aplikoj në Ministri për përtëritje të licencës, për ta dorëzuar dokumentacionin, pastaj i nënshtrohet procedurave të vlerësimit dhe duke krijuar kosto dhe humbje kohe pasi që në kontinutet është duke aftësuar kandidatët për shofer nga pjesa praktike, si edhe humbje kohe dhe kosto për institucionin i cili i mban provimet profesionale të kësaj fushe, të emëroj ekipe punuese nga zyrtaret të cilët largohen nga punët ditore të përshkruar sipas vendit të punës duke u merr me aktivitete shtesë siç ishte rasti i përshkruar më lartë.

Procedurat e panevojshme administrative për përtërije të licencës për pyetës të drejtimit (neni 37).
Është rasti i njëjtë sikurse te instruktor shoferi, humbje kohe, kosto për pyetëset që janë në kontinutet në procesin e vlerësimit të testimit nga pjesa praktike si dhe për institucionin i cili mban provimet profesionale në këtë fushë.

b) *Zvarritje të ofrimeve të shërbimeve të Institucioneve, subjekteve dhe kuadrit profesional në procesin e marrjes së patentë shoferit*

Te neni 30 i ligjit në fjalë ka paqartësi sa i për ketë nën paragrafit 1.2. ku cekët " ka së paku të përfunduara studimet - nivelin Bachelor nga lëmi i komunikacionit". Ka paraqitur probleme te kandidat për pyetës të cilët e kanë përfunduar masterin në lëmin e komunikacionit deri sa Bechelorin e kanë nga fushat tjera, ku janë ballafaquar me zvarritje për ta vazhduar aktivitetin në fushë veprimin e tyre.

Te dispozitat e nenit 63, 2.7 dhe 2.8 ka mos harmonizim të dispozitave sa i për ketë masës më të madhe te lejuar të bashkësisë së mjeteve të kategorisë CE.
Në paragrafin 2 të pikës 2. 7 është përcaktuar se Automjet i kategorisë C me masën më të madhe të lejuar duhet të jetë së paku 12000 kg, derisa në pikën 2.8 është përcaktuar se bashkësi e mjeteve (CE) , masën më të madhe të lejuar duhet ta ketë msë paku 20.000 kg, a të njëjtën pikë ceket se "...
Rimorkioja duhet të jetë përkatëse ashtu që masa e përgjithshme të jetë së paku 15.000 kg", qe rezulton se automjet tërheqës dhe rimorkio e tejkalon masën më të madhe te lejuar prej së paku 20.000kg. Ky nen ka krijuar konfuzion në zbatim si pasoj ka ngecje te puna e subjekteve që merren me aftësimin e kandidatëve për shofer, me rastin e licencimi dhe përtëritjes së licencës.

Te neni 94 shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët dojnë ta konvertojnë patentë shoferin tonë në ndonjë shtet tjetër, kanë pengesa ligjore, sepse nuk munden ta ndërrojnë patentë

shoferin vetëm gjashtë (6) muaj para skadimit të afatit të vlefshmërisë p.sh shteti Gjermani e konverton vetëm modelin e ri të Patentë Shoferit tonë, i cili ka filluar të lëshohet nga viti 2018, e ka banor qe posedon modelin e vjetër të patentë shoferit qe i vlen patentë shoferi deri në vitin 2033. Prandaj me dispozita ligjore në fuqi nuk mund ta ndërroj patentë shoferin.

Zyrtari, i emëruar nga Ministria, i cili e mban provimin teorik për patentë shoferi, duhet t'i plotësojë kushtet në vijim ai ose ndonjë anëtar i familjes së ngushtë të tij në tre (3)vjetët e fundit të mos ketë qenë i angazhuar në çfarëdo mënyre në autoshkollë (neni 27. 1.6.). Kjo dispozitë i ka përjashtuar personat nga ushtrimi i veprimtarisë së pyetësit teorik pasi që shumica e tyre janë të kyçur në fushën e patentë shoferit pasi që ekziston ndërlidhja aftësim-vlerësim të kandidatëve për shoferë.

Te dispozitat e nenin 28 paragrafi 1 dhe 2 është përcaktuar se " Vlerësimin e kandidatëve për shoferë nga pjesa praktike e kryen personi i licencuar për pyetës, i autorizuar me vendim të Ministrit dhe caktimi i pyetësve bëhet sipas radhës së plotë të listës. Duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me një proces të vlerësimit të provimit nga pjesa praktike ku kërkohet punë profesionale dhe është në kontinutet e që nën kupton nuk është projekt me afat kohor, andaj angazhimi sipas radhitjes së listës jep mundësin që pyetësit profesionist të kësaj pune të largohen nga procesi i testimit deri prapë nuk i vjen radha që ka prodhuar efekt negativ. Të njëjtit gjatë kohës së mos angazhimit në këtë proces detyrohen të merren me aktivitet tjera e jo me punën profesionale të tyre, e që mund të rezultojë ne efekt negativ në punën e tyre profesionale në këtë fushë.

Për pyetës të drejtimit mund të licencohet personi i cili i plotëson kushtet në vijim: " në tri (3) vitet e fundit ai ose ndonjë anëtar i familjes së ngushtë të tij të mos ketë qenë i angazhuar në çfarëdo funksioni në auto shkollë (neni 30 nën nënparagrafi 1.7). Kjo dispozitë ka krijuar zvarritje në punët e institucioneve dhe për kuadrin profesional në procesin e marrjes së patentë shoferit, duke ju nënshtruar procedurave të qartësimit të kësaj çështje, dhe të noterzimit të deklaratave të kuadrit profesional duke humbur kohë dhe impakt socio-ekonomik.

Personi i cili ka marrë pjesë në vlerësimin e kandidatëve për shoferë (në cilësinë E pyetësit) nuk i lejohet të themelojë apo të punojë në çfarëdo funksioni në auto shkollë një (1) vit nga date fundit e mbajtjes së provimit (neni 124). Kjo dispozitë ka prodhuar efekt negativ pasi që personi i cili ka punuar si vlerësuar në testimin e kandidatëve për shoferë, ai/ajo duhet të pres një vit e pastaj mund të angazhohet në fushën e patentë shofer, me këtë ka krijuar impakt socio-ekonomik duke krijuar zvarritje të shërbimeve në procesin e marrjes së patentë shoferit.

*c)Largimi i kuadrit profesional nga procesi i marrjes së patentë shoferit*

Me hyrjen e ligjit për patentë shofer në mënyrë retroaktive, ka lanë jashtë një numër të kuadrit profesional të kësaj fushe edhe pse i kanë kaluar të gjitha trajnimet me aktet normative në fuqi që kanë qenë, nuk e kanë marr bazë as përvojën profesionale me një

bagazh të madh në këtë fushë të tyre. Të njëjtë e kanë përgatitjet e larta shkollore por drejtimin nuk e kanë siç është kërkuar me këtë ligj vetëm në lëmin e komunikacionit.

Ligjëruesi profesional bazuar në nenin 10 nën paragrafin 1.2. duhet t'i këtë të përfunduara studimet nga vetëm nga lëmi i komunikacionit, të barasvlershme me së paku 120 ECTS, sipas sistemit të Bolonjës; që nënkuptohet me tjera drejtime nuk ju ka mundësuar vazhdimi i veprimtarisë në këtë fushë. Efektet e kësaj dispozitë janë që janë larguar kuadri profesional me një përvojë shumë vjeçare duke pasur impakt socio-ekonomike për këtë kategori të kuadrit profesional, duke i lan jashtë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Për pyetës të drejtimit mund të licencohet personi i cili i plotëson kushtet në vijim: "i ka së paku të përfunduara studimet - nivelin Bachelor nga lëmi i komunikacionit" (neni 30 nën paragrafi 1.2). Me hyrjen e kësaj dispozite në mënyrë retro-aktive ka rezultuar se pyetësit me drejtime tjera shkollore nuk ju ka mundësuar vazhdimi i veprimtarisë në këtë fushë, është rasti i njëjtë sikurse te ligjëruesi profesional duke prodhuar efekt negative ku pyetësit e drejtimit janë mbetur jashtë procesit të vlerësimit të kandidatëve për shoferë, të cilët e kanë pasur përgatitjen e lartë shkollore por drejtimin tjera e jo të komunikacionit edhe pse disa drejtime shkollore kanë ndërlidhje me procesin e marrjes së patentë shoferit. Nga kjo që u cekë më lartë ka rezultuar se pyetësit e drejtimit pavarësisht bagazhit të përvojës së tyre në këtë janë përjashtuar nga ky proces.

Në nenin 28 paragrafi 2 parashihet dispozita se "Caktimi i pyetësve bëhet sipas listës së plotë të pyetësve të licencuar, me radhë". Sipas kësaj dispozite pyetësit e drejtimit të cilët kanë profesionalizëm të lartë, do të largohen nga procesi i vlerësimit në procesin e marrjes së patentë shoferit për të pritur kohën për ri-aktivizim dhe gjatë kësaj kohe nuk do të ushtroj profesionin e pyetësit qe mund të ketë efekt negativ në profesionalizimin e tij.

*d) Mos implementimi i Direktivave Evropiane si dhe të standardeve dhe praktikave të vendeve të zhvilluar të BE-ës në procesin e marrjes së patentë shoferit*

Krahasuar me vendet e BE-ës të zhvilluar kemi standarde dhe praktika tjera në procesin e marrjes se patentë shoferit të cilat janë elaboruar në vijim:

-Në procesin e marrjes së patentë shoferit nuk janë përfshirë të gjitha Direktivat Evropiane në Fushën e Patentë shoferit dhe as standardet dhe praktika me vendet me të zhvilluar të BE-ës;

- Edhe pse ka progres në procesin e testimit teorik, ku tani veç ka filluar në mënyrë elektronike të zbatohet nga fillimi i këtij vitit në tërë vendin tonë, ende paraqiten vështirësi dhe pengesa të natyrës së ndryshme si ato teknike -elektronike;

-Të gjithë akterët e përfshirë në proces të marrjes së patentë shoferit nuk janë të lidhur në një sistem unik -data bazë që të përcjell efikasiteti i punës së tyre;

-Eliminimi i faktorit njeri në procesin e testimit teorik nuk është në tërësi, gjë që do të ndikonte në ngritjen e kualitetit në procesin e marrjes së patentë shoferit;

-Testimi praktik, pjesa e parë në poligon nuk parashihet me Direktivave Evropiane as nuk zbatohet te vendet me të zhvilluar të BE-ës,

-Standardet minimale të aftësive psiko- fzike të kandidatëve dhe shoferëve nuk janë në përputhje të plotë me Direktivave Evropiane për patentë shoferë.

-Vlerësimi i shkathtësive dhe i sjelljes për kategoritë B1, B dhe BE; ku përfshin së paku dy veprime (neni 63 paragrafi 4), të cilat kryhen në poligon (neni 63 paragrafi 6), nuk parashihen në legjislacionin e vendeve më të zhvilluar të BE-ës dhe sipas Direktivave Evropiane.

-Mungon dispozita e cila rregullon caktimin e modaliteteve të automjeteve të cilat drejtohen nga personat me aftësi të kufizuar.

*e)Zvogëlimi i sigurisë rrugore dhe ndotja e ambientit*

Siguria rrugore dhe ndotja e ambientit është e ndërlidhur drejtpërsëdrejti me procesin e marrjes së patentë shoferit. Largimi i kuadrove profesionale në fushën e patentë shoferit me një bagazh disa vjeçar ndikon në zvogëlimin e sigurisë rrugore si dhe në mbrojtjen e ambientit .
Proces i marrjes së patentë shoferit nuk është sipas Direktivave Evropiane për patentë shofer dhe sipas standardeve dhe praktikave më të mira të vendeve të zhvilluar të BE-ës, që ka rezultuar negativisht në sigurinë rrugore.
Siguria rrugore është njëri ndër kushtet për konvertimin e patentë shoferit të Republikës së Kosovës në patentë shoferin e ndonjë shtetit tjetër, që me zvogëlimin e sigurisë rrugore do të ketë imapkt për mos konvertimin e patentë shoferit të vendit tonë.

## *Kapitulli 1.3. Palët e interisuar*

Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit, janë të paraqitura shkaku, efektet si dhe mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak apo efektin në të paraqitura në figurën 4.

*Figura 4: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit*

| Emri i palës së interesuar | Shkaku-qet me të cilat është e lidhur pala | Efekti-et me të cilat është e lidhur pala | Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet) |
|---|---|---|---|
| Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, Departamentet relevante | Mangësitë ligjore<br>Mangësitë ligjore | Ngarkesat administrative<br>Mungesa e kapaciteteve<br>Barriera administrative | Direkt |
| Departamenti i Automjeteve | Mangësitë ligjore | Ngarkesat /Barriera administrative | Direkt |
| Departamenti i Patentë shoferit | Mangësitë ligjore | Mungesa e kapaciteteve | Direkt |
| Shoqëria civile | Niveli i ultë i kualitetit dhe siguria rrugore | Barrierat | Indirekt |
| Shoqatat e auto shkollave | Mungesa e të mirave publike | Ngarkesa/barrierat administrative | Direkt |
| Profesionistet në fushën e patentë shoferit | Mungesa e të mirave publike | Barrierat administrative | Direkt |
| Aplikantet për patentë shoferë | Mangësitë ligjore | Ngarkesat administrative | Direkt |

## Kapitulli 1.4. Zbatimi i acquis së BE-së

Sipas Direktivës Evropiane 2006/126/EC për patentë shofer janë përcaktuar:

- procedurat e lëshimit vazhdimit dhe ndërrimit të patentë shoferit, masat parandaluese nga keq përdorimeve eventuale si dhe formati i patentë shoferit ( Kapitulli i VIII i ligjit Nr.05/L-064 për patentë shoferi),
- kërkesat Minimale për provimin teorik për kategoritë përkatëse (neni 62 i Ligjit Nr.05/L-064 për patentë shoferi),
- kërkesat minimale për provimin praktik për automjetet (neni 63, paragrafi 2 dhe 3, të Ligjit Nr.05/L-064 për patentë shoferi)
- vlerësimi i shkathtësive dhe i sjelljes për kategoritë përkatëse(neni 63 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-064 për patentë shoferi)
- standardet minimale të aftësive psiko-fizike të nevojshme për ngasjen e automjeteve (neni 77) ,

- standardet minimal per personat qe kryejnë pjesën praktike te provimit te shoferit (neni 28-31 Ligjit Nr.05/L-064 për patentë shoferi).

Nga ajo që u cekë më lartë në legjislacionin tonë janë të përfshira kriteret dhe standardet që janë të përfshira në Direktivën Evropiane për patentë shoferi, mirëpo prej hyrjes në fuqi të Ligjit për patentë, ka plotësim dhe ndryshim të kësaj Direktive të cilat nuk janë të përfshira në legjislacionin tonë që rregullon fushën e patentë shoferit.

Me Direktivën evropiane nuk parashihen standardet për subjektet që bëjnë aftësimin e kandidatëve për shofer, as për Ligjëruesin profesional i cili mban pjesën teorike të provimit pasi që ekzistojnë modelet e ndryshme të aftësimit të kandidatëve për shoferë, por është kompetencë e secilit vend anëtarë të Be-ës.

Me Direktivën Evropiane nuk parashihet poligoni por veprimet e veçanta për kategoritë përkatëse në shumicën e vendeve të zhvilluar te BE-ës kryhen në rrugë publike.

Sa i përket pyetësve teorik të cilët mbajnë provimin teorik nuk janë të përcaktuar standardet me Direktivë Evropiane për patentë shofer, ashtu që secili vend i BE-ës përcakton metodën e mbajtjes së provimit nga pjesa teorike.

Për pyetësit e ngasjes janë përcaktuar standardet minimale sipas Direktivës së lartë cekur, të cilat janë të përfshira. Nuk është paraparë ripërtërija e licencës por Ruajtja e nivelit të kualitetit dhe ngritja profesionale periodike për pyetës të drejtimit siç është përcaktuar në legjislacionin tonë në fushën e patentë shoferit.

# Kapitulli 2: Objektivat

Ky koncept dokument i ka katër objektiva:

- Eliminimi i barrierave dhe të ngarkesave administrative burokratike të Institucioneve dhe subjekteve të cilat janë të përfshira në procesin e marrjes së patentë shoferë.
- Rikthimi i kuadrit profesional në procesin e marrjen së patentë shoferët .
- Eliminimin e mos përputhjes të neneve dhe të ligjeve që kanë ndërlidhje me fushën e patentë shoferit.
- Ngritja e cilësisë së procesit të marrjes së patentë shoferit duke u bazuar në standardet dhe praktikat më larta në vendet e BE-ës dhe përfshirjen e Direktivave Evropiane

*Figure 5: Objektivat relevante të Qeverisë*

| Objektivi relevant | 3.4.3. Hartimi I Projek Ligjit për Patent Shoferë |
|---|---|
| Objektivat strategjike | Përmirësimi i performancës institucionale dhe sektoriale me fokus në sigurinë rrugore, hekurudhore dhe ajrore |
| Objektivi specifik | Sipas këtij Koncept Dokumenti |
| Qëllimi i politikës – Fuqizimi i fushës së patentë shoferit | Sipas këtij Koncept Dokumenti |

# Kapitulli 3: Opsionet

## *Krahasimi me vendet tjera*

Gjatë hartimit të këtij koncept dokument janë hulumtuar dhe shqyrtuar korniza ligjore dhe politikat që rregullojnë fushën e patentë shoferit të vendeve të rajonit Shqipëri, Mal të Zi, Maqedoni, të vendeve të zhvilluar perëndimore Gjermani , Suedi dhe Zvicër.

### *SHQIPËRIA*

Fusha e patentë shoferit është rregulluar me "Kodin Rrugor i Republikës së Shqipërisë" që nënkupton se nuk ka ligj të veçantë në këtë fushë. Me këtë Kod dhe aktet nënligjore janë përcaktuar procedurat e marrjes së patentë shoferit, ndër më rëndësishme që do ti shërbejë këtij koncepti janë:

- Trajnimi i kandidatëve realizohet në auto shkolla të licencuar bazuar në ligjin "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve tjera normative. Nuk parashihet procedurat e përtëritjes së licencës.
- Mësues i teorisë i cili është edhe drejtuesi teknik i auto shkollës; duhet të jetë i diplomuar inxhinier mekanik (profili mekanik) dhe të jetë i pajisur me dëshmi të aftësisë profesionale;
- Instruktori i praktikës të ketë të paktën diplomë të arsimit të mesëm, dëshmi të aftësisë profesionale për leje drejtimi.
- Provimi i teorisë bëhet pranë DRSHTRR-së, ku ka adresën auto shkolla, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe.
- Provimi i teorisë zhvillohet me aparat komunikimi audio për personat që kanë kufizime në leximin e gjuhës së shkruar.
- Provimi praktik pjesa e parë realizohet në poligon, pjesa e dytë në rrugë publike.
- Provimi epet para komisionit prej tre anëtarësh të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

*MALI I ZI*

Korniza ligjore që rregullon fushën e patentë shoferit është paraparë me Ligjin për Siguri në Trafikun rrugor dhe aktet nën ligjore të nxjerra në bazë të këtij ligjit, ndër të tjera parashihet:

- Trajnimi i kandidatëve realizohet në auto shkolla të licencuar dhe nuk parashihet përtëritja e licencës.
- Ligjëruesi teorik realizon lëndën nga rregullat e trafikut dhe sigurisë- pjesën teorike.
- Instruktor shofer duhet të ketë të paktën diplomë të arsimit të mesëm.
- Shpenzimet për aftësimin e kandidatëve për shoferë sipas dispozitave dhe certifikatën e lëshuar për trajnim për dhënien e ndihmës së parë i bartë kandidati që trajnohet.
- Çmimi nga lënda ndihma e parë duhet të jetë i arsyeshëm i cili bazohet në shpenzimet për: stafin profesional, ambientet e punës, pajisjet për zbatimin e programit dhe lëshimi i certifikatës së kualifikimit të ndihmës së parë.
- Provimi i teorisë zhvillohet në mënyrë elektronike.
- Provimi praktik pjesa e parë realizohet në poligon, pjesa e dytë në rrugë publike.
- Provimi epet para komisionit prej tre anëtarësh të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuar:

  a) dy ekzaminues (Niveli VII1 i kualifikimit arsimor) të autorizuar, njëri prej të cilëve është përfaqësues i organit të administratës shtetërore përgjegjës për çështjet e arsimit dhe tjetri përfaqësues i organit kompetent; dhe
  b) një përfaqësues i auto shkollës i cili duhet të ketë patentë shofer instruktori për të gjitha kategoritë e mjeteve për të cilat auto shkolla ka licencë, të paktën 23 vjeç dhe që nuk i është shqiptuar masa mbrojtëse ndalimi i drejtimit të automjetit në dy vitet e fundit.
- Licenca për një ekzaminues të autorizuar lëshohet për një periudhë pesëvjeçare.
- Ligjëruesi teorik, instruktor shoferi dhe anëtarët e komisioneve të provimit janë të detyruar të ndjekin seminaret e zhvillimit profesional për tu mundur ta vazhdojnë veprimtarin në fushën e tyre.

*REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT*

Korniza ligjore që rregullon fushën e patentë shoferit është paraparë me Ligjin për Siguri në Trafikun rrugor dhe aktet nën ligjore të nxjerra në bazë të këtij ligjit, ndër të tjera parashihet:

- Trajnimi i kandidatëve realizohet në auto shkolla të licencuar dhe nuk parashihet përtëritja e licencës.
- Ligjëruesi teorik realizon lëndën nga rregullat e trafikut dhe sigurisë- pjesën teorike. Ligjëruesi duhet të ketë Nivelin e VI i kualifikimit të arsimit - programi studimor i komunikacionit rrugor ose programi studimor i shkencave juridike dhe së paku tre vjet përvojë pune në fushën e sigurisë në trafik.
- Instruktor shofer të ketë të paktën diplomë të arsimit të mesëm IV.
- Provimi i teorisë zhvillohet në mënyrë elektronike.

- Provimi praktik pjesa e parë realizohet në poligon, pjesa e dytë në rrugë publike.
- Provimi epet para komisionit prej tre anëtarësh të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuar:
  a)ketë licencë ekzamineri nga pjesa teorike;
  b)të posedojë licencë ekzamineri nga pesa praktike dhe
  c)të ketë përvojë pune të paktën tre vjet në trajnimin ose provimin e kandidatëve për shoferë, ose përvojë pune si kontrollues ose drejtues qendre provimi. Licenca për një ekzaminues të autorizuar lëshohet për një periudhë pesëvjeçare.

- Ligjëruesi teorik, instruktor shoferi dhe anëtarët e komisioneve të provimit janë të detyruar të ndjekin seminaret e zhvillimit profesional për tu mundur ta vazhdojnë veprimtarin në fushë veprimin e tyre.

Ekzaminues nga pjesa teorike mund të jetë personi i cili përveç kushteve tjera duhet të ketë përfunduar arsimin e lartë.

Ekzaminues nga pjesa praktike mund të jetë personi i cili i plotëson këto kushte të veçanta:
- të ketë përfunduar së paku arsimin e mesëm;
- ka vendbanim në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- zotëron aftësi të përgjithshme shëndetësore psikofizike, të cilën e vërteton me vërtetim përkatës mjekësor;
- të jetë i punësuar në qendrën e provimit me kohë të plotë ose të pacaktuar;
-- posedon patentë shofer-instruktor nga kategoritë për të cilat qendra e provimit vlerëson kandidatët për shofer;
- të posedojë licencë për ekzaminues nga pjesa praktike dhe
- të ketë përvojë pune të paktën tre vjet në trajnimin ose provimin e kandidatëve për shoferë.

Kontrollues i provimit mund të jetë personi i cili i plotëson këto kushte:

- të ketë përfunduar arsimin e lartë;
- ka vendbanim në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- zotëron aftësi të përgjithshme shëndetësore psikofizike, e cila vërtetohet me vërtetim përkatës mjekësor;
- të jetë i punësuar në qendrën e provimit me kohë të plotë ose të pacaktuar;
- të ketë patentë shofer-instruktor;
- licencën e kontrolluesit dhe
- të ketë përvojë pune të paktën tre vjet në trajnimin ose provimin e kandidatëve për shoferë, ose përvojë pune si kontrollues ose drejtues qendre provimi.

Kandidatët për të punuar si ligjërues, shofer-instruktor në auto shkollë, kontrollues, ekzaminues nga pjesa teorike dhe ekzaminues nga pjesa praktika në qendrën e provimeve, duhet të të kalojë provimin profesional për aftësinë për punë.

**Përmbledhje**: Në shtet e rajonit fusha e patentë shoferit është rregulluar në kuadër të Kodit të Qarkullimit Rrugor përkatësisht të Ligjit për Siguri në Trafikun Rrugor. Trajnimi i kandidatëve realizohet në auto shkolla të licencuar. Trajnimin nga pjesa teorike e mban ligjëruesi i autorizuar,

ndërsa pjesa praktike realizohet nën mbikëqyrjen e instruktor shoferit. Provimi nga pjesa teorike realizohet nëpërmjet sistemit elektronik. Pjesa praktike realizohet në poligon, ndërsa pjesa e dytë në rrugë publike. Provimi mbahet nga komisioni tre anëtarësh ku njeri prej anëtarëve është përfaqësues i auto shkollës.
Për ta vazhduar profesionin kuadrat profesionale, Ligjëruesi, Instruktor shoferi, ekzaminuesi, dhe kontrollori duhet ti vijon seminaret ose trajnimet.

*GJERMANIA*

Fusha e patentë shoferit parashihet me ligj dhe aktet nënligjore që rregullojnë fushën e patentë shoferit. Trajnimi i kandidatëve realizohet në auto shkollë e cila është e autorizuar nga organi kompetent.
Për të hapur një auto shkollë, personi duhet të plotësoj kërkesa në vijim:

- duhet të jetë së paku 25 vjet dhe
- të paktën 2 vjet përvojë profesionale (zakonisht si instruktor shofer i punësuar);
- një leje zyrtare për hapjen e auto shkollës;
- automjetet e trajnimit;
- zyrën dhe klasën mësimore;
- materiali mësimor;
- mos pengesa ligjore për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

Hapësirat punuese mund të jenë edhe me qira.

*Instruktori shoferi*

Sipas ligjit kushdo që ka aftësi psiko-fizike dhe pedagogjisht dhe i besueshëm personalisht mund të marrë lejen e instruktor shoferit.
Vërtetimi mbi aftësitë psiko- fizike konstatohen me certifikatë mjekësore.
Kandidati duhet të ketë aftësi profesionale dhe pedagogjike për t'u bërë instruktor shofer duke përfunduar me sukses provimet e përcaktuar për instruktor të shoferëve.

Kërkesat për trajnimin e instruktor shoferit janë:

- patentë shoferin e kategorisë :B së paku tri vite,
- certifikatën mjekësore,
- mosha minimale 21 vjeç,
- së paku tre vjet përvojë drejtimi në patentë shoferit të kategorisë " B",
- aftësi personale (vërtetohet duke paraqitur një certifikatë përkatëse),
- certifikata ekzistuese e përfundimit të shkollës,
- diplomë e shkollës së mesme ose diplomë profesionale, dhe
- patentë shoferin e kategorisë për kategorisë përkatëse.

Për ta marr lejen e instruktor shoferit duhet të kaloj trajnimin në një shkoll të instruktor shoferit dhe të jap provimin nga pjesa teorike dhe praktike.

Kursi i teorisë, i cili zgjat rreth pesë muaj, përafërsisht 1000 orë mësimore duhet të kryhen, nga të cilat 540 orë i kushtohen vetëm pedagogjisë. Për pjesën teorike janë planifikuar përafërsisht pesë muaj. Së pari kryhet trajnimi teorik pastaj ai praktik.
Si pjesë e mësimeve praktike, instruktorët e ardhshëm të shoferit duhet të kryejnë një praktikë pesë mujore në një auto shkollë.

Urdhëresa për instruktorin e shoferit nuk përmbante një rregullore për ri dhënien e patentës së instruktorit të shoferit pas ri lëshimit të lejes së drejtimit.

*Ekzamineri*

Personi për tua bërë ekzaminer i ngasjes duhet ti plotësoj kërkesat në vijim:

-për të paktën tre vjet të posedoj patentë shoferin,
-të paktën 23 vjeç.
-një kualifikim profesional të nivelit 3 (kualifikimi bazë i trajnimit në përputhje me 85/368/EEC),
- një diplomë në inxhinieri nga një universitet, kolegj teknik ose akademi profesionale dhe të paktën 18 muaj përvojë praktike, profesionale përkatëse.

Pyetësi nuk mund të punojë njëkohësisht si instruktor shofer në një auto shkollë gjatë ushtrimit të profesionit ekzaminues.

Pyetës mund të bëhet edhe inxhinieri automjeteve, inxhinieri mekanike ose inxhinieri elektrike me një diplomë, diplomë bachelor ose master. Të kesh një punë në sektorin e automobilave është e dobishme, por jo detyrueshme.

Për ta marr patentë shoferin është e nevojshme të kaloni testin teorik dhe praktik. Kërkesat për të dyja testet varen nga kategoria për të cilën do të merret patentë shoferi.
Për çdo klasë patentë shoferi janë të detyrueshme 12 orë "programit bazë" të mësimit teorik. Është e lejueshme trajnimi praktike nëse nuk i keni ndjekur të gjitha mësimet teorike

***SUEDI***

Fusha e patentë shoferit është rregulluar me ligj dhe aktet nënligjore ku janë përcaktuar procedurat dhe aktivitet për marrjen e patentë shoferit.
Auto shkollat mund të funksionojnë vetëm me leje nga Agjencia Suedeze e Transportit.
Kërkesat për të marrë leje për funksionimin e auto shkollës janë:

- një drejtues auto shkollës,
- të paktën një ligjërues në çdo vend ku zhvillohet mësimi,
- një ose më shumë instruktorë shoferë.

Aplikacioni duhet të bashkëngjitet:

- një vërtetim se aplikanti nuk është shpallur i falimentuar, nëse aplikanti është person fizik, ose
- një certifikatë regjistrimi nga Zyra Suedeze e Regjistrimit të Kompanive, nëse aplikanti është një person juridik.

Dëshmia nuk mund të jetë më e vjetër se tre muaj.

Kushdo që dëshiron të punojë si mësues trafiku duhet të aplikojë për miratim nga Agjencia Suedeze e Transportit. Për t'u miratuar në një aplikim, duhet, ndër të tjera, të ketë patentë shoferi, të ketë përfunduar trajnimin e mësuesve të trafikut dhe më pas të kalojë testin e aftësisë së Agjencisë Suedeze të Transportit.

Trajnimi zgjat 1,5 vjet dhe zhvillohet me kohë të plotë (jo nga distanca) 15 javë, LIA si mësues trafiku.

Një mësues trafiku mëson kandidatë që do të marrin patentë shoferin: për motoçikletë, veturë, autobus, rimorkio ose kamion. Trajnimi është teorik dhe praktik, ku pjesa teorike shpesh zhvillohet në grup. Mësuesi i mëson kandidatëve rregullat e trafikut, ndërgjegjësimin për trafikun dhe mjedisin e trafikut.

Më parë, kërkesa ishte të paktën 18 orë ngasje, tani numri i orëve është reduktuar në dhjetë. Orët e teorisë së detyrueshme janë ulur nga 19 në 4.

Testi i provimit ka të bëjë për testin e njohurive ("teoria") dhe testin e drejtimit në trajnimin për patentë shofer. Aplikanti mund t'i nënshtrohet provimit në Administratën Suedeze të Transportit.
Testi i njohurive zakonisht kryhet në kompjuter dhe përbëhet nga 70 pyetje, nga të cilat 65 janë me pikë, për t'u përgjigjur brenda 50 minutave. Kërkohen 52 përgjigje të sakta për të kaluar. 5 pyetjet pa pikë janë vendosur rastësisht në test dhe janë për të testuar veten nga, se është vendosur në mënyrën e duhur, që nuk mund të keqinterpretohet.
Përveç testit të përgjithshëm, ka edhe teste njohurish të zgjeruara, përkatësisht 75 dhe 90 minuta, ku testi 90 minuta është me gojë. Këto teste të zgjeruara janë vetëm për ata me vështirësi në lexim dhe shkrim. Autoriteti vendos, në bazë të dokumentacionit që aplikanti i dërgon Administratës suedeze të Transportit, se cili test do t'i nënshtrohet. Dokumentacioni nga një mjek ose person tjetër i autorizuar mund të jetë maksimumi dy vjet.
Gjatë provimit të ngasjes, kandidati testohet nga një inspektor nga një nga zyrat e provimit të drejtimit të Administratës Suedeze të Transportit. Testi zgjat gjithsej rreth 45 minuta. Fillon me një kontroll sigurie. Ngasja e aplikantit më pas testohet në trafikun rrugor urban dhe rural, ku aplikanti testohet në disa momente të zgjedhura rastësisht në trafik. Ngasja zgjat të paktën 25 minuta. Aplikanti duhet të keni përfunduar dhe të jeni miratuar për kurset e trajnimit për rrezikun 1 dhe 2 (të rrëshqitshëm) përpara se të mund të bëni testin në Administratën Suedeze të Transportit.

Inspektorët nuk kanë një kuotë të caktuar që sa duhet të dështojnë çdo ditë ose javë.

*ZVICRA*

Testet teorike në të gjitha kategoritë kryhen në një kompjuter tabletë. Testi i teorisë bazë përmban 50 pyetje. Ekzistojnë tre opsione përgjigjeje për secilën pyetje. Një ose dy nga këto përgjigje mund të jenë të sakta. Për kategoritë A1, A, B dhe B1 (50 pyetje), kategoritë F dhe G (40 pyetje) dhe në kategorinë M (30 pyetje) disa përgjigje mund të jenë të sakta. Provimi kalon nëse nuk e kalon numrin maksimal të pikëve të gabimit varësisht nga kategoria.
Provimi praktik i ngasjes përfshin drejtimin në trafik me funksionimin e automjetit, duke iu përshtatur kushteve të rrugës, trafikut dhe dukshmërisë dhe veçorive të veçanta të mjetit dhe ngarkesës.

Për të hapur një auto shkollë, duhet të plotësohen disa kërkesa:

- Posedimi i patentës së instruktorit të shoferit.
- 2 vite përvojë profesionale si instruktor shoferi (me kohë të plotë)
- Përfundimi me sukses i trajnimit të mëtejshëm në fushën e administrimit të biznesit të auto shkollës me të paktën 70 orë nga 45 minuta secila
- duhet një leje zyrtare e auto shkollës.

Kërkesat për modulin e trajnimit B (instruktor shoferi).

-Niveli i mesëm II ose kualifikim i krahasueshëm,
-Të kuptuarit e gjuhës në nivelin e shkollës së mesme II (të paktën niveli B2)
-Provim profesional,
- Posedimi i leje drejtimit të kategorisë B së paku 3 vjet
- Autorizimi për transportin profesional të pasagjerëve (BPT, Kodi 121)
- Dy vite përvojë profesionale.

Kursi intensiv zhvillohet gjatë javës dhe zgjat gjithsej 12 muaj, duke përfshirë edhe provimin profesional. Kurset ekstra-profesionale zhvillohen të shtunave, trajnimi zgjat gjithsej 23 muaj.

*Përmbledhje*: Në shtet e zhvilluar te BE-ës dhe në Zvicër, kriteret janë shumë liberal për hapjen e auto shkollës, nuk ka nevojë të ketë dy instruktor shoferë, hapësira punuese poligoni nuk është kusht për marrjen e autorizimit për hapjen e auto shkollës. Provimi teorik mbahet në mënyrë elektronike, ndërsa provimi nga pjesa praktike realizohet vetëm në rrugë publik, që nënkupton nuk realizohet në poligon siç është rasti te shtet e rajonit. Provimi nga pjesa praktike jepet para ekzaminuesit të ngasjes, ndërsa te shtetet e rajonit para komisionit tre anëtarësh.
Ligjëruesi, instruktor shoferi dhe ekzaminuesit e provimit duhet të vijon seminaret/trajnimet për vazhdimin e veprimtarisë në fushëveprimin e tyre.

Grupi punues për hartimin Koncept Dokumentit në fushën e patentë shoferit ka shqyrtuar tri opsione të poshtë shënuar me qëllim të realizimit të objektivave, të parapara në Kapitullin 2.

Opsioni i parë është opsioni status quo, pra opsioni pa ndryshim.
Opsion i dytë është opsioni i përmirësimit të zbatimit dhe zbatimit të kuadrit aktual ligjor.
Opsioni i tretë është Ligji i Ri në procesin e marrjes së patentë shoferit.

## Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim

### Opsioni i parë

Mbetja në gjendjen ekzistues ndikon në ngecje/vështirësitë në procesin e marrjes së patentë shoferit:

- Institucionet që merren me lincencimin dhe mbajtjen e provimit në fushën e patentë shoferit ballafaqohen ne procedura burokratike duke formuar komisioni për përtrirje të licencës për subjekte që merrin me aftësimin e kandidatëve për shoferë dhe për mbajtjen e provime për ripërtrirje të licencës duke humbur kohë të panevojshme dhe të kosto.

- Subjektet të cilat merren me aftësimin e kandidatëve do të vazhdojnë me ngarkesa administrative dhe burokratike të panevojshme me rastin e përtrirjës së licencës, duke krijuar kosto dhe humbje kohe të panevojshme, për aplikim të ripërtrirjes të licencës, , pritja e komisionit për verifikimin e kushteve për përtrirje të licencës, pa pasur nevojë pasi që në kontiniutet janë objekt i inspektimit të inspektoriatit të Auto shkollave në kuadër të Ministrisë. Aplikimi për lincencim të autoshkollës apo përtrirje të saj, ndërrimi i kushteve hapsinore, kuadrit profesional, përkatësisht mjeteve të punës vetëm në divizionin e autoshkollave me seli në Prishtinë vazhdohet të mbesin në dëmë të autoshkollave për shkak të centralizimit burokratik, gjë që nuk ju mundësojn qasje të lehtë dhe të shpejtë për kryrjen e shërbimeve të auto shkollave.

Pastaj ngarkesat administrative për hapsirat punuese dhe personelin e subjekteve për afësimin e kandidatëve për shoferë, do të vazhdohet me krijimin e kostove të panevojshme pa pasur ndikim në ngritjen e cilësisë në fushë veprimin e tyre.

- Udhëheqësi administrativ profesional më tutje mbetët barrë e subjekteve, pasi që udhëheqësi profedional merret me punët e rëndomta administrative i cili krijon kosto subjekteve pa ndikuar në procesin e aftësimit të kandidatëve për shoferë. Angazhimi i instruktor shoferit për secilën kategori shtesë, më tutje veç krijon kosto të panevojsme, pasi që disa kategori janë jo fitim pruese për shkak të numrit të vogël të kandidatëve për shoferë sidomos kur ka të bëjnë me kategoritë e mjeteve bashkangjitëse.

- Mbetja në gjendje ekzistuese kuadrim profesional e lenë më tutje jashtë procesit te marrjes së patent shofer i cili ka impakt socio-ekonomik, si pasojë e hyrjes së ligjit për patentë shoferë në mënyrë retro aktive, i cili parasheh se vetëm personat me përgatitje

shkollore në lëmin e komunikacionit mund të vazhdojnë punën në fushën e patentë shoferit, duke përjashtuar personat tjera me përgatitje të lartë të fushave tjerave pavarsisht përvojes së tyre disa vjeçare në këtë fushë.

- Kuadri profesional të cilët kanë përgatitjen shkollore në lëmin e komunikacionit i cili ushtron veprimtarin në fushën e patentë shoferit më tutje do të ballafaqohet me procedurat burokratike me rastin e përtrirjes së licincës pavarisht se në vazhdimësi është në kryrjen e punës në fushë veprimin e tyre. Të njëjetit për shkak të centralizimit burokratik duhet të aplikojnë vetëm në Divizionin e Autoshkollave me seli në Prishtinë, duke bërë me qindra kilometra vetëm për paraqitjen e provimit, pastaj prap për marrjen e licencës.

- Dispozitat ligjore kontraditore dhe të paqarta paraqesin në vazhdimësi probleme në fushën e patentë shoferit të cilat do të mbesin në gjendje ekzistuese. Dispozita që ka të bëjë me rimorkio vazdon të paraqes konfizion në zbatim si te veprohet për çështjen në fjalë.

- Do të vazhdoj mbetje e pa qartë lidhur me kushtet e licencimit të kuadrit profesional në fushën e patentë dhe mënyrës së angazhimit të pyetësve për patentë shoferë që janë në kundërshtim me ligjet tjera që janë të nderlidhura në fushën e patentë shoferit.

- Dispozita mbi masën më të madhe të lejuar për bashkësinë e mjeteve CE, për subjketet që merren me aftësimin e kandidatëve për patentë do të vazhdoj gjendja ekzistue duke u ballafaquar me problem me rastin e lincencimit përkatëssht të përtrirjes së licencës,duke humbur kohë dhe kosto të panevojshme duke pritur komisionet e ministrisë që të vlersojnë dhe të vendosen lidhur për rastin në fjalë.

- Mbetja në gjendjen ekzistuese shtetasit tanë do të ballafaqohen me tutje me probleme lidhur me konvertimin e patentë shoferit të vendit tonë në patentë shoferin e ndonjë shtetit tjetër, për shkak se për konvertimin e patentë shoferit tonë pranohet vetëm modeli i ri, siq e kemi rastin me Gjermonin, nërsa ndërrimi i patentë shoferit nuk lejohet më herët se gjashtë muaj para skadimit të vlefshmërisë së tyre.

- Dispozitat e vjetërsuar dhe të pazbatueshme vetëm krijon ngarkesa dhe kosto të panevojshme në procesin e marrjes së patentë shoferit pasi që me funksionizimin e digjitalizimit nuk kan nevojë të mbesin.

- Mos përfshirja e standardave dhe praktikave më të mira të vendeve më të zhvilluar të BE-ës dhe vendeve perindimore dhe mos përfshiraj e Direktivave Evropiane do të vazhdohet me ngecje në cilësinë në fushën e patentë shoferit.

Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit, vlerësoi se përmes këtij opsioni, problemet e njëjta, që ballafaqohen deri më tani, do të vazhdojn të mbesin.

## Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit

Gjendja është diç më e favorshme se sa te opsioni i parë, me përjashtim të disa dispozitave te cilat mund të rregullohen me legjislacionin sekondar të cilat janë paraqitur në vijim:

- Aplikimi për licencimin dhe përtërije të licencës së auto shkollës për kategoritë përkatëse, ndërrimi i hapësirave punuese, kuadrit profesional, mjeteve të punës mund të realizohet nëpërmjet sistemit on-line apo duke e paraqitur kërkesën nëpër Njësit Rajonale të Patentë Shoferit të cilat funksion në kuadër të Ministrisë, kjo nënkupton eliminimin e procedurave burokratike të centralizuar. Aplikimi për përtërije të licencës krijon zvarritje humbje kohe dhe kosto duke pritur auto shkolla pajisjet me licencë, gjatë kësaj kohe nuk i lejohet ushtrimi i veprimtarisë.

- Verifikimi i njohurive të instruktor shoferëve edhe pse është rregulluar me legjislacionin sekondar nëpërmjet seminareve duke akumuluar pikët, për shkak të procedura administrative paraqesin vështiri në zbatim. Mirëpo procedurat e aplikimit për përtërije të licencës nuk mund të eliminohen pasi që është i parë me ligjin primar në fushën e patentë shoferit, kjo krijon zvarritje humbje kohe dhe kosto duke pritur instruktorët të pajisën me licencë, të njëjtëve gjatë kësaj kohe nuk i lejohet ushtrimi i veprimtarisë. Paraqitja e provimit për licencimin e instruktor shoferit mund të realizohet nëpërmjet sistemit on-line apo duke e paraqitur provimin nëpër Njësit Rajonale të Patentë Shoferit të cilat funksion në kuadër të Ministrisë ruajt e dokumentacionit në mënyrë fizik apo elektronike në NJRPSH-it, nënkupton eliminimin e procedurave burokratike të centralizuar.

- Verifikimi i njohurive të ligjërueseve profesional mund të rregullohet me legjislacionin sekondar nëpërmjet seminareve duke akumuluar është rasti i njëjtë sikur se te instruktor shoferët. Mirëpo procedurat e aplikimit për përtërije të licencës së ligjëruesit nuk mund të eliminohen pasi që është i parë me ligjin primar në fushën e patentë shoferit, kjo krijon zvarritje humbje kohe dhe kosto duke pritur ligjëruesit t'ju nënshtrohet provimit profesional për përtëritje të licencës, pastaj pritja e tyre derisa nuk pajisjen me licencë, të njëjtëve gjatë kësaj kohe nuk i lejohet ushtrimi i veprimtarisë. Paraqitja e provimit për ligjëruesit profesional mund të realizohet nëpërmjet sistemit on-line apo duke e paraqitur provimin nëpër Njësit Rajonale të Patentë Shoferit të cilat funksion në kuadër të Ministrisë, kjo nënkupton eleminimin e procedurave burokratike të centralizuar. Ministria do të lirohet nga emërimi i komisioneve për mbajtjen e provimeve profesionale për përtrirjen e licencës për ligjëruesin profesional.

- Verifikimi i njohurive të pyetësve të cilët e mbajnë provimin teorik dhe pyetësve të drejtimit mund të rregullohet me legjislacionin sekondar nëpërmjet seminareve duke akumuluar pikët është rasti i njëjtë sikur se te instruktor shoferët. Mirëpo procedurat e aplikimit për përtretje të licencës të pyetësve nuk mund të eliminohen pasi që është i parë me ligjin primar në fushën e patentë shoferit, kjo krijon zvarritje humbje kohe dhe kosto duke pritur pyetësit t'ju nënshtrohet provimit profesional për përtretje të licencës, pastaj pritja e tyre derisa nuk pajisjen me licencë, të njëjtëve gjatë kësaj kohe nuk i lejohet ushtrimi i veprimtarisë në fushëveprimin e tyre. Paraqitja e provimit për ligjëruesit profesional mund të realizohet nëpërmjet sistemit on-line apo duke e paraqitur provimin

nëpër Njësit Rajonale të Patentë Shoferit të cilat funksion në kuadër të Ministrisë, pa pasur nevojë që pyetësit të vijnë në Ministri-Prishtinë për paraqitjen e provimit apo marrjen e licencave, kjo do të rezultonte me eliminimin e procedurave burokratike të centralizuar.

*Opsioni 3: Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit*

Eliminimi i problemeve që janë identifikuar në fushën e patentë shoferit do të jenë të mundshëm vetëm nëse bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr.05/L-064 për Patentë Shoferi dhe akteve nënligjore të cilat nxjerrin në bazë të këtij ligjit që rregullon fushën e patentë shoferit, në mënyrë kronologjike janë paraqitur opsioni i tretë me propozimet në vijim

- Aplikimi për licencim të auto shkollës, për ndërrim të kushteve të licencimit do të bëhet nëpërmjet sistemit on-line, ndërsa kopja fizike apo elektronike do të mbesin në NJPSH-it në kuadër të Ministrisë.
- Sa i për ketë kushteve të licencimit të auto shkollës nuk do të parashihet hapësirat punuese- poligoni, te personeli profesional të ketë vetëm një instruktor shofer për të gjitha kategoritë tjera. Aplikimi do të bëhet nëpërmjet sistemit on-line dhe dokumentacion për licencim apo ndryshimit të kushteve të licencimit të auto shkollave në kopje fizike do të mbesin në NJPSH-it në kuadër të Ministrisë ku i për ketë selia e auto shkollës. Vetura e tretë mund të jetë me kontratë.
- Për udhëheqësit profesional në auto shkollë parashihet që të hiqet si kusht për licencimin e subjekteve të cilat bëjnë aftësimin e kandidatëve për shoferë.
- Nuk parashihet përtërija e licencës për auto shkolla.
- Sa i për ketë përgatitjes shkollore të ligjëruesit profesional në auto shkollë përveç studimeve në lëmin e komunikacionit do të parashihen edhe nga lëmit tjera nga fusha që kanë ndërlidhje me proces të marrjes së patentë shoferit si dhe ri kthimi i të gjithëve ligjërueseve profesional të cilat kanë licencë, që do t'ju mundësohet vazhdimi i veprimtarisë së tyre në këtë fushë.
- Nuk parashihet përtërija e licencës për ligjëruesin profesional në auto shkollë, por vazhdimi i profesionit të tyre kushtëzohet me ndjekjen e seminareve, ndërsa përtërija e licencës do të parashihet vetëm për ligjëruesit profesionale që nuk janë aktiv në procesin në fushë veprimin e tyre.
- Institucionet që merren me vlerësimin e kandidatëve në provime profesionale përkatësisht të instruktor shoferë, zyrtarët të emëruar nuk do të kushtëzohen me përgatitje shkollore të vetëm nga një lëmi, dhe kjo çështje do të rregullohet me akte nënligjore varësisht nga fushëveprimi i tyre profesionale.

- Nuk parashihet përtërija e licencës për instruktor shofer, por vazhdimi i profesionit të tyre kushtëzohet me ndjekjen e seminareve, ndërsa përtërija e licencës do të parashihet vetëm për instruktor shoferë që nuk janë aktiv në proces të fushë veprimit te tyre.
- Do të parashihet trajnimi bazë për instruktor shoferë për kategorinë "A" si kurse për kategorinë "B".
- Do të largohen barrierat dhe kushtëzimet sa i për ketë licencimit të vlerësueseve të provimeve në patentë shoferë, nga dy pjesët e provimit dhe do të eliminohet paqartësi lidhur me çështjen në fjalë.
- Sa i për ketë angazhimit të vlerësueseve të provimit do të harmonizohet me ligjin zyrtar publik se kemi të bëjmë me një proces në vazhdimësi dhe nuk do të bëhet caktimi i tyre sipas radhës së listës por në bazë të kualitetit të punës së tyre.
- Kushtet për licencimin për vlerësuesit nga pjesa praktike përveq studimeve në lëmin e komunikacionit do të parashihen edhe nga lëmit tjera nga fusha që kanë ndërlidhje me proces të marrjes së patentë shoferit si dhe ri kthimi i të gjithëve vlerësuesve nga pjesa praktike e provimit të cilat kanë licencë, që do t'ju mundësohet vazhdimi i veprimtarisë së tyre në këtë fushë.
- Nuk do të parashihet përtërija e licencës për vlerësuesit e provimit nga pjesa praktike, por vazhdimi i profesionit të tyre kushtëzohet me ndjekjen e seminareve, ndërsa përtërija e licencës do të parashihet vetëm për vlerësuesit nga pjesa praktike që nuk janë aktiv në procesin e fushë veprimit të tyre.
